

SIGKOS SH.A.

**Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin e
përfunduar më 31 dhjetor 2024**

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Për Aksionarët e Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a.

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjeve të përshkruara në seksionin Bazat për opinionin e kualifikuar të raportit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin e përfunduar në atë datë në përputhje me politikat kontabël të shpalosura në shënimin 2.1.

Bazat për opinionin e kualifikuar

- Siç shpaloset në shënimin 7.1 të pasqyrave financiare shoqëruese, primet e cedura të Kompanisë për risiguruesit arrijnë në 463 mijë euro. Kompania regjistroi rreullime për primet e ceduara risiguruesve në vlerën 84 mijë euro në vitin aktual që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe detyrimet e kryera në vitet financiare 2022 dhe 2023. Njohja e kësaj shume në periudhën aktuale ka rezultuar në një mbivlerësim të shpenzimeve të vitit aktual dhe nënvlerësim të shpenzimeve dhe rezultateve të periudhës së mëparshme.
- Siç është shpalosur në Shënimin 24 të pasqyrave financiare shoqëruese, rezerva e dëmeve pezull të Kompanisë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 arrin në 6,584 mijë euro dhe 4,116 mijë euro përkatësisht, duke përfshirë shumat e dëmeve të raportuara por të pa paguara ("RBNS") prej 4,997 mijë euro dhe 2,625 mijë euro përkatësisht. Në shumën e rezervave të RBNS më 31 dhjetor 2024 përfshihen rezervat në shumën prej 750 mijë eurosh që lidhen me produktet e garancisë që i janë raportuar Kompanisë në vitet e mëparshme, por nuk janë njohur në pasqyrat financiare të viteve të mëparshme. Njohja e kësaj shume në periudhën aktuale ka rezultuar në një mbivlerësim të shpenzimeve të vitit aktual dhe nënvlerësim të shpenzimeve dhe rezultateve të periudhës së mëparshme për vitin.

Përveç kësaj, shuma totale e kërkesave që lidhen me produktet e garancisë që janë në procedurë gjyqësore dhe për të cilat është njohur rezerva e RBNS prej 750 mijë eurosh në vitin 2024, arrin në 1,897 mijë euro. Për shkak të natyrës së të dhënave të ofruara, ne nuk ishim në gjendje të bënim vlerësimin tonë dhe të vlerësonim me siguri të arsyeshme mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e këtyre rezervave të RBNS për këto kërkesa. Si pasojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse është i nevojshëm ndonjë rregullim në bilancin e RBNS më 31 dhjetor 2024, si dhe në humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve dhe rezultatin për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në përgjegjësitë e auditorit për auditimin e seksionit të pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

Pasiguria Materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë

Siç është shpalosur në Shënimin 3, pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur duke supozuar se Kompania do të vazhdojë së përmbushuri hipotezën e vijimësisë.

Humbja neto e Kompanisë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 është 1,724 mijë euro dhe më 31 dhjetor 2024, humbjet e akumuluar arrijnë në 1,378 mijë euro. Përveç kësaj, më 31 dhjetor 2024, Kompania raportoi pamjaftueshmëri të kapitalit prej 710 mijë eurosh dhe një mungesë të Aseteve që mbulojnë provizionet teknike në shumën prej 999 mijë eurosh.

Këto kushte tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e Kompanisë për të vazhduar së përmbushuri hipotezën e vijimësisë.

Aftësia e Kompanisë për të vazhduar përmbushjen e hipotezës së vijimësisë varet nga disponueshmëria e burimeve të vazhdueshme të financimit dhe mbështetja e vazhdueshme financiare dhe e çdo lloji mbështetje tjetër nga aksionarët e saj. Aksionarët e Kompanisë, në letrat e tyre të datës 11 Prill 2025, konfirmuan se janë në gjendje dhe do të vazhdojnë t'i ofrojnë Kompanisë mbështetje financiare për ta mundësuar atë të vazhdojë operacionet e saj dhe të përmbushë të gjitha kërkesat rregullatore për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e këtyre letrave.

Më 28 Mars 2025, bazuar në vendimin e lëshuar nga BQK-ja, të dy aksionarët e Kompanisë paguan një shumë totale prej 1,000,000 eurosh për të përmbushur kërkesat rregullatore dhe për të korrigjuar mungesën e kapitalit dhe mungesën e asetëve që mbulojnë provizionet teknike më 31 dhjetor 2024. Që nga data e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, kapitali shtesë nuk ishte regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Pasqyrat financiare shoqëruese nuk përfshijnë rregullime në lidhje me rikuperueshmërinë dhe klasifikimin e shumave të asetëve të regjistruara, as shumat dhe klasifikimin e detyrimeve që mund të kërkojnë nëse Kompania nuk vazhdon së përmbushuri hipotezën e vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar më tej në lidhje me këtë çështje.

Informata tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë shtojcat plotësuese të cilat përfshijnë "Margjinën e solvencës" dhe "Pasuritë që mbulojnë detyrimet e sigurimeve". Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon edhe informatat tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë formë sigurie apo konkluzioni mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat tjera dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë auditimit ose në të kundërtën duket të jetë materialisht e keqdeklaruar. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, vijmë në përfundim se ekziston një anomali materiale e këtyre informatave tjera, neve na kërkohet t'a raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë aspekt.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat e kontabilitetit të shpalosura në shënimin 2.1, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar së përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Kompania mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Kompania të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a., përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
30 prill 2025


Suzana Stavrikj
Auditor ligjor



KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024**

		Për fund vitin 31 dhjetor 2024 (në Euro)	Për fund vitin 31 dhjetor 2023 (në Euro)
	Shënime		
Primet bruto të shkruara	7	4,783,835	6,473,154
Primet e lëshuara ri-siguruesve	7.1	(463,153)	(342,758)
Neto primet e shkruara		4,320,681	6,130,396
Neto ndryshimi i rezervave për primet e pa fituara	25	677,839	(137,862)
Primi i fituar neto		4,998,521	5,992,534
Të ardhura nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS)	8	339,544	506,715
Të hyrat nga interesi	9	218,337	183,947
Të hyrat tjera	10	369,015	559,618
Gjithsej të hyrat		5,925,417	7,242,814
Humbjet dhe shpenzimet e dëmeve pezull (Ndryshimi) Rezervat për dëmet e raportuara (Risigurimi)	24	(5,417,331)	(3,923,210)
Shpenzime për Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS)	8	3,531	-
Shpenzimet e marrjes në sigurim (Ndryshimi) Kostot e shtyera të marrjes në sigurim	13	(165,360)	(230,433)
Shpenzimet administrative	12	(486,721)	(705,577)
		(79,228)	133,967
		(1,450,172)	(1,802,218)
Gjithsej shpenzimet		(7,595,279)	(6,527,471)
Fitimi para tatimi		(1,669,863)	715,343
Tatimi në fitim	14	(54,224)	(217,327)
(Humbja) Fitimi Neto		(1,724,086)	498,016
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje:			
Rivlerësimi i asetëve		105,786	149,888
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve		(81,956)	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		(1,700,257)	647,904

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare


KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar
Më 31 dhjetor 2024

		Më 31 dhjetor 2024 (në Euro)	Më 31 dhjetor 2023 (në Euro)
Pasuritë	Shënim		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	15	231,144	170,956
Depozitat	16	10,043,752	9,705,652
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	17	307,038	211,917
Kosto e shtyrë e marrjes në sigurim	18	389,100	468,329
Pasuritë e risigurimit	25	41,880	55,639
Pasuritë tjera rrjedhëse	21	492,927	748,664
Pasuritë me të drejtë përdorimi	22	148,557	321,303
Prona dhe pajisjet	19	1,810,539	1,837,352
Pasuritë e paprekshme	20	57,491	36,374
Gjithsej pasuritë		13,522,428	13,556,186
Ekuiteti i aksionarëve dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	23	3,519,796	3,519,796
Rivlerësimi i rezervës		961,354	937,525
(Humbje) Fitim të akumuluar		(1,377,629)	346,457
Gjithsej ekuiteti		3,103,521	4,803,778
Detyrimet			
Rezerva e dëmeve pezull	24	6,584,282	4,116,462
Rezerva e primit të paguar	26	3,046,890	3,724,729
Llogaritë e pagueshme të sigurimit		67,060	62,733
Llogaritë tjera të pagueshme	27	569,853	633,652
Detyrimet e qirasë	22	68,866	214,832
Detyrimi tatimor i shtyrë		81,956	-
Gjithsej detyrimet		10,418,907	8,752,408
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve		13,522,428	13,556,186

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe lëshuara nga menaxhmenti dhe janë nënshkruar në emër të tij më 22 prill 2025.



Drita Kadriu Berisha
Drejtoreshë e Përgjithshme



Aulona Sadiku
Drejtoreshë Financiare

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet****Më 31 dhjetor 2024**

	Kapitali Aksionar	Rezervat e rivlerësuara	Fitimi / Humbja e akumuluar	Gjithsej Ekuiteti
	(në Euro)	(në Euro)	(në Euro)	(në Euro)
Gjendja më 1 janar 2023	3,519,796	787,637	(151,557)	4,155,876
Shtim Kapitali	-	-	-	-
(Humbja)Fitimi i vitit	-	-	498,016	498,016
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	149,888	-	149,888
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,519,796	937,525	346,457	4,803,778
Gjendja më 1 janar 2024	3,519,796	937,525	346,457	4,803,778
Shtim Kapitali	-	-	-	-
(Humbja)Fitimi i vitit	-	-	(1,724,086)	(1,724,086)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse – rivlerësimi i pronës dhe pajisjeve	-	105,786	-	105,786
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve	-	(81,956)	-	(81,956)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	3,519,796	961,354	(1,377,629)	3,103,521

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e rrjedhës së parasë****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024**

	Shënim	Për fund vitin 31 dhjetor 2024 (në Euro)	Për fund vitin 31 dhjetor 2023 (në Euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi për vitin		(1,724,086)	498,016
<i>Rregullimet për vitin:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12	315,034	371,184
Ngarkesa nga zhvlerësimi i provizionit për të arkëtueshmet		86,254	223,947
Ngarkesa nga provizionimi i aseteve tjera		34,997	61,962
Të ardhurat nga interesi	9	(235,118)	(202,897)
Shpenzimet e interesit		16,781	18,950
		(1,506,138)	971,162
<i>Ndryshime në pasuritë operative</i>			
Të arkëtueshmet nga sigurimi		13,760	31,427
Kostot e shtyera të marrjes në sigurim		79,228	(133,967)
Pasuritë tjera rrjedhëse		219,136	(340,255)
		(1,194,015)	528,367
<i>Ndryshimet në detyrimet operative</i>			
Humbja në provizionimet e dëmeve pezull		2,467,819	1,147,380
Provizionimi për primet e pafituara		(677,839)	137,861
Të pagueshmet tjera dhe tregtare	27	(77,123)	(135,319)
Tatimi në fitim	27	(132,642)	(18,727)
Të pagueshmet e risigurimit		4,327	16,536
Paraja neto e përdorur nga aktivitetet operative		390,527	1,676,098
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës dhe pajisjeve	19	(4,884)	(8,776)
Blerja e pasurive të paprekshme		(33,095)	-
Rritja e depozitave	16	(338,101)	(1,600,446)
Interesi i arkëtuar		201,016	187,839
Paraja e përdorur në aktivitetet investuese		(175,063)	(1,421,382)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesat e qirasë gjatë vitit	22	(155,276)	(201,436)
Shtimi i kapitalit		-	-
Paraja e (përdorur në) gjeneruar nga aktivitetet financuese		(155,276)	(201,436)
Rritja/zvogëlimi neto në para të gatshme dhe ekuivalentët e parasë		60,188	53,281
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	15	170,956	117,675
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	15	231,144	170,956

Shënimet e shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare